

**INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR
KREDI ME KUFİ (OVERDRAFT) PERSONA ME AFTESI TE KUFIZUAR**

Prezantim	Ky informacion përbën një prezantim të ofertës që Banka do të bejë sipas kushteve aktuale të tregut. Ky informacion nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Dhënia e informacionit sipas këtij dokumenti nuk parasheh detyrimin e Bankës për të akorduar kredi.
1. Banka	“Banka e Pare e Investimeve”, ALBANIA Sh.a Adresa: Bulevardi “Deshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 2, kati 14, Tiranë. Adresa e Web-it: www.fibank.al Telefona pa pagese 08000111; Tel 042276702/3; Fax: 042280210
2. Emri i Produktit	Kredi me Kufi (Overdraft) për “Persona me aftësi të kufizuar”
3. Qëllimi i produktit	Qëllimi i kredisë me kufi (Overdraftit) është për të plotësuar nevojat afatshkurtra për likuiditet të klientëve
4. Përshkrimi i produktit	Banka nuk kërkon as hipotekeë dhe as garanci të palëve të treta për këtë produkt. Ky produkt ju ofrohet vetëm klientëve të cilët tërheqin pagën nëpërmjet Fibank. Banka i jep mundësi klientit për të tërhequr apo për të urdhëruar transfertë deri në një limit të caktuar, duke e kaluar gjendjen efektive të mjeteve në llogarinë rrjedhëse. Interes për shumën e përdorur do të paguhet në fund të çdo muaji. Limitet e këtij produkti janë: - Nje pagesë asitencë mujore është limit i paraaprovuar.
5. Norma e Interesit	Për kredinë me kufi (overdraftin) e miratuar, do të aplikohet interes mbi balancën debitore të llogarisë rrjedhëse për shumën e kredisë me kufi (Overdraft) në masën: <i>11.9% - Për kredinë me kufi (overdraft) në monedhë vendase</i> Interesi llogaritet çdo ditë dhe do të paguhet çdo fund muaji mbi balancën debitore të llogarisë rrjedhëse të kredisë me kufi (overdraft), duke filluar nga dita e parë e përdorimit të kredisë me kufi (overdraft) në bazë të shumës së përdorur. Interesat përkatëse dhe shumat e tjera të detyrueshme për Huamarrësin do të llogariten në bazë të ditëve efektive, duke pranuar vitin me 360 ditë. $\text{Interesi} = \text{Limit i përdorur} * N.\text{interesit} * \text{Ditët e përdorura} / 360 \text{ ditë}$
6. Norma efektive e interesit (NEI)	Është totali i kostos së kredisë me kufi (overdraft) për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e limitit të kredisë me kufi (overdraft) të dhënë dhe e llogaritur në përputhje me kërkesat e rregullores së bankës së Shqipërisë “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare financiare”, e bazuar në supozimin që kontrata e kredisë që do të firmoset është e vlefshme për afatin kontraktor dhe palët përmbushin rregullisht detyrimet sipas kushteve dhe mënyrës së rënë dakord në kontratë.
7. Afati maksimal, shuma maksimale dhe monedha e kredisë	Shuma maksimale- deri në 1 pagë neto Kredia me kufi (overdraft) ofrohet në të njëjtën monedhë me pagën e klientit dhe ofrohet në LEKË. Afati maksimal-deri në 12 muaj dhe në varësi të ditës së fundit të certifikatës së paftësisë. Afati përfundimtar mund të shtyhet vetëm pas dorëzimit në bankë të certifikatës së paftësisë së rifreskuar. Nqs nuk mund të nxirret certifikata përpara datës së fundit të shlyerjes së kredisë me kufi (overdraftit), klienti duhet të mbylle plotësisht ekspozimin.

8. Vlera e kredisë	
9. Kohezgjatja e kontrates se kredisë	_____ muaj
10. Plani i amortizimit	Interesi paguhet çdo fund muaji i llogaritur për shumën dhe ditët e përdorura. Principali mund të paguhet në çdo moment i plotë ose i pjesshëm sipas dëshires së klientit. Principali = Limiti i përdorur NEI = _____% <i>Pëllogaritja e NEI-t është pjesë integrale bashkangjitur këtij dokumenti</i>
11. Shuma totale qe konsumatori do te kete per te paguar	Shuma e totalit e OVD = _____ (Vlera e Kryegjese + Vlera e Interesit + Vlera e komisionit te manaxhimit + kosto mirembajtje llogarie)
12. Tërheqja e fondeve	Limiti i kredisë me kufi (overdraft) do ti akordohet klientit në llogarinë e pagës dhe përdorimi i tij do të krijojë një tepricë debitore në kete llogari. Lëvrimi do të bëhet me tërheqje kesh , transfertë tek të tretët ose me mjete elektronike. Kur banka konstaton se Kredimarrësi ka dalë jashtë kushteve të parashikuara në Kontratën e kredisë me kufi (overdraft) nënshkruar nga palët, Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e menjëhershëm të shumës së kredisë me kufi dhe të gjithë detyrimet te lidhura me të përmes një njoftimi me shkrim nga ana e bankës
13. Kosto shtesë e detyrueshme për përfitimin e kredisë	Komision menaxhimi: 2% mbi shumën e miratuar të kredisë me kufi (overdraft) në ditën e disbursimit të kredisë me kufi (overdraft)
14. Shlyerje para afatit të maturimit	Klienti ka të drejtë të kryejë në cdo kohe, para afatit të maturimit, shlyerjen e pjesshme ose të plotë të kredisë pa asnjë komision
15. Kosto shtesë te tjera	Kosto e mbajtjes së llogarisë: Për çeljen e llogarisë rrjedhese në të cilën do të lëvrohet kredia me kufi dhe kryerjen e pagesave për interesat mujore të kredisë me kufi (overdraft), Banka do të aplikojë komisionin në masën prej 90 lekë në muaj
16. Njoftimi zyrtar midis paleve	Banka informon klientin një herë në vit për gjendjen e llogarisë, duke përcaktuar informacionin në lidhje me periudhën kalendarike të cilës i referohet gjendja e llogarisë. Të gjithë njoftimet komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim të dorëzuara personalisht ose me postë në adresën e depozituar pranë bankës ose kur është e mundur me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (SMS, email, disket, CD ROM, DVD, kuti postare etj). Kredimarrësi është i detyruar që për çdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brenda 15 diteve kalendarike për këto ndryshime. Për sa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, kredimarrësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bëra në adresën e mëparshme

17. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredisë	Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga Kontratë e Kredisë me kufi (overdraft) brenda një periudhë kalendarike 14 ditore. Ky afat fillon nga dita e nënshkrimit të kontratës së kredisë me kufi (overdraft). Përpara ushtrimit të kësaj të drejte Kredimarrësi duhet të njoftojë Bankën brenda periudhës së sipërpërmendur. Në rast se në këtë moment Banka ka disbursuar shumën e kredisë me kufi (overdraft), kredimarrësi është i detyruar të kthejë shumën e kredisë me kufi (overdraft), interesat për ditët përkatëse si dhe shpenzimet e kryera nga Banka në funksion të disbursimit të kredisë me kufi (overdraft).
18. Ankimi	- Ankese me shkrim pranë cdo dege - Nëpërmjet telefonit: Telefono pa pagese 08000111 Tel 042276702/3 Fax: 042280210
19. Penalitete të tjera	Në rast se kredimarrësi e kalon limitin e miratuar nga banka, ai do të paguajë interesin prej 36% i llogaritur mbi shumën me të cilën kalohet limiti i miratuar dhe kohën që është kaluar limiti. Nëse nuk janë siguruar mjetet financiare të nevojshme në ditën e përfundimit të afatit të paradhënies së akorduar, kredia me kufi (overdraft) konsiderohet si i palejuar. Pagesat e detyrueshme të pashlyera në afat për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve në llogarinë rrjedhëse të kredimarrësit në bankë, kalojnë në pagesë me kamatëvonesë me përqindje interesi në masën prej 36% mbi balancën debitore të llogarisë së kredimarrësit. Banka aplikon mbi shumën e tërë limitit të përdorur (principalit të pamaturuar) normën prej 1% përgjatë gjithë kohës që kredimarrësi do të jetë në shkelje dhe/ose mospërbushje të një prej detyrimeve që rrjedhin nga kontrata që do të firmoset mes palëve
20. Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor	Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 7 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti
21. E drejta e paisjes me kopjen e projektkontratës së kredisë	Konsumatori ka të drejtën për t'u pajisur, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, me një kopje të projektkontratës së kredisë. Kjo e drejtë nuk do të zbatohet nëse banka, në kohën e kërkesës, nuk është e gatshme të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me konsumatorin.

Kredimarrësi
(konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)
(Emër, mbiemër, nënshkrimi)

Data e nënshkrimit
(____/____/20__)